



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 53, datë 18.04.2025

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“KOMPLEKSI PRAN' DIELLIT, GODINA HOTELERIE, BANIMI DHE SHËRBIMESH**  
**ME 9, 10, 11 DHE 13 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE PARKIM NËNTOKË”, ME**  
**VENDNDODHJE NË ORIKUM, BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Asper Konstruksion” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleksi Pran' Diellit, Godina hotelerie, banimi dhe shërbimesh me 9, 10, 11 dhe 13 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Orikum, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Asper Konstruksion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 13/05 2026